

FATOS ARAPI

# SHTIGJE

## *Poetike*

BIBLIOTEKA

BH-7  
A73

TIRANE, 1962

891983-1

85H-1.

773

FATOS ARAPI

BIBLIO

GJIKOVARSKIP

SHTETE III

~~32289~~

11366

# SHTIGJE POETIKE

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»  
TIRANË, 1962

1-47  
54

3588  
1936

SHIGLE BOETIKE

1936

# NETË NËN ARMIKUN

---

Ju pat lindur nëna për një bot' të ré...

Populli

Ju u nisët të rinj, nëpër shtigje ëndrash të reja.  
Na përshëndetët me një shprehje, që s'e njihnim  
gjer aherë:

«Vdekje fashizmit». Në buzët tona ju shuat em a  
të vjetër e prapë të rinj. të porsa lind ur të tjerë:  
Qaf' Pëllumbi, Patos, Mallakastër, Martanesh.

Ju ndezët zjarret e rinj të alarmeve të reja që  
vinin.

Atdheut i dolët përpara me fytyrën e dëshëruar  
të së ardhmes.

I pëshpëritët fjalë dashurish, që s'i kish dëgjuar,  
s'i dinte.

Fjalë dashurish për njerinë.

Dhe, si dashuri e vërtetë, mbetet të rinj.

## C O P R I F U O C O

Hapat e patrullës godasin në trupin e metaltë të natës.

Gjer në tokë krrusen e rrasen shtëpiat përdhese.

Mendimet lëvizin në koka të njerëzve

dhe thërmohen pastaj pëshpërime nga buzët e vura rreth vatrës.

Kjo orë vjen e ngarkuar me zjarr dhe hekur.

Si një xhandar i egër qëndron para dyerve të shtëpisë.

Pyet veten: «përse të hapura?» —

Dhe si përgjigje tund kokën, helmetën.

Dhe si kërcënim i metaltë patrullon errësirës.

Dyert mbeten të hapura:

mund të hyjë nër' to liria ilegale e Shqipërisë.

## R O B È R I T

Gjysëmehëna e ngrënë, si një fjalë thënë përgjysëm.  
Mamareja e vjetër, si një mendim turk.  
Në hajatin e heshtur-heshtin robërit e luftës.  
Në qafa t'italianëve - një zinxhir edhe kryq,  
apo një madonë që na sheh si me turp.  
Me thonjt e fëlliqur  
robërit kruajnë mjekrat e trasha...  
Dhe shikojnë lart gjysëmehënë e ngrysur,  
veten e tyre, ne krahor Jesu Krishti...

Shqipëria partizane patrullon përjashta.

# DRASHOVICA

---

1. Nata shkon shaluar mbi kurriz të maleve.  
Nata sqqipëtare,  
nata partizane  
nata e ngarkuar me klithma t'alarmeve.

Nata shkon shaluar mbi kurriz të maleve.

Nëpër trup të saj kollonat gjermane  
kacaviren, ngjiten;  
skuatrat partizane  
i presin si thikë.

Nata shkon shaluar mbi kurriz të maleve..  
Nata e ngarkuar me klithma t'alarmeve.

2. Prap sulen drejt nesh mendimet e egra.  
Helmetat prej hekuri ngjeshur përmbi vetulla.  
Në duart e veta  
mbajnë bajoneta.  
Me çizme të rënda.  
Evropa u tkurr nënë ato çizme  
dhe nën gozhdat-dhëmbë, për të tyret ëndra.

Me gjak të lirive duart kanë lyer  
dhe shikojnë agimet mes kryqe h të thyer,  
Po vijnë drejt nesh mendimet e egra...

3. Tri pushkë një bombë! 1)  
Tri pushkë një bombë!

Përmbi Drashovicë nata dha kushtrimin  
Dhe në qiellin tonë  
hënën rreh si gong.

4. Brofën gjith në këmbë ëndrat partizane  
Mbi kondak të pushkës  
kishin pshtetur kryet - merrnin një sy gjumë.  
Ëndrat partizane...  
Nëpër shtigjet tona të lodhura shumë.

U gjendën në këmbë këngët partizane.  
Kapëzat me yje i ngjeshën mbi sy.  
Këngët partizane...  
Pararoje trime përherë ndër alarme.

5. Oh! moj Drashovicë.  
Trup me trup përleshën  
jo lebër e fricë,  
Kryqëzat e thyer  
dhe yjet e kuq  
fytas janë mbërthyer

Dorë e çuditëshme kjo e historisë:  
sonte hedh me grushta përmbi Drashovicë  
dhe kryqet e thyer dhe yjet e kuq.

Dhe ndeshen këtu:  
Shqipërizë e vogël; - nazizmi qikllop;  
bujku i revoltuar-junker i krekosur.  
revolucion i trim  
reaksion' i xhindosur.

---

1) Sinjali i alarmeve partizane.

## II

1. Një risk të hollë qielli kemi përmbi krye.  
Netëve mbi ne - vetëm një grusht yje;  
Këtu tek kjo grykë netët vijnë me sulme.  
Nëpër agullime fillojnë kundrasulme.

Dhe përshkojnë plumbat, ashtu, nëpër trup  
dhe urrejtjen tonë  
dhe dashurinë tonë.  
I përshkojnë plumbat, ashtu, nëpër trup.

2. Nëpër trup kanë prerë  
plumbat këtë herë  
këtë kryq të thyer.  
More kryq i thyer me fytyrë nieri:  
dokumentat thonë ke emrin Valter.  
More kryq i thyer me emrin Valter!

Ti ishe që brodhe i pirë Parizit,  
pe vallen kankan në «Foli Berzher»  
edhe pastaj shkove e vrave Peri-në? 1)

More kryq i thyer dhe ti paske gjak.  
Gjak kishin liritë.  
gjak kishin dhe këngët,  
ëndrat që vrave rrugve — kishin gjak.

3. Porsi sy të egiër, netët po i nresin  
drita prozhektorësh; kryqëzohen, thyhen  
nënër trup të netëve drita prozhektorësh.  
Nën rrymat e tyre  
sulen nartizanët, kapërxejn' llogoresh

---

1) Gabriel Peri — antar i K.Q. të P. K. Franceze push-  
katuar nga nazistët gjermanë.

Plumbat i kafshojnë; plumbat po i grijnë  
ashtu copëz-copëz.  
Si vetë këto ditë,  
si vetë këto netë  
grirë e bërë fërtele  
nga mijra gryk' pushkësh, topash, mitrolozash.

Kollitet, si plak  
i regjur ndër luftra, mitrolozi «Sharc».  
Si ulkonjat dimrit enden autobлиндat.  
Dhe mbi kryet tona si shpend' ugruzeza,  
aeroplanat hedhin hiet që nga lart.  
Hej! mor qiell budallë!  
Herët kësaj vjeshte  
nise dallëndyshet  
për Arabistan.  
Dhe solle me vdekien tonë të ngarkuar,  
«Stukas»-it gjermanë.  
Përmbi kryet tona «Stukas»-it i mban,

Ashtu!

Mitrolozin e pështet mbi zverq  
Shqipëri paruzane, qiellin qëllo!  
Gri edhe conto  
dhe zemrën e ngrysur të qiellit vetë.

### III

1. Ku shkoni xhixhi!? Ku shkoni xhixhi!?  
— Po u vijnë krahë — djemt' e nënave.  
— Armiku qëllon — kërcëni xhixhi!  
— Le të qëlloj qeni — djemt' e nënave.

Korbë Drashovicë.  
Shamizeza lidhur, labja Drashovicë.

- Ismetin e vranë, 1)
- Vdekja është kaq pranë  
sa, po zgjati dorën, një nga një na prek.
- Ulu! mortaja godet...
- Si një misernike e verdhë kjo hënë.
- Mos na kujto bukën!
- Nga uria toka lëkundet nën këmbë...

3. Me vlagë të vjeshtës  
tokën e punojmë.  
Dhe ti, Drashovicë, tani mund të ishe  
ar' e bukës sonë.

Po në gji të dheut farë nuk po hedhim.  
Me dashuritë tona, Drashovicë, të mbjellim.

Dashuritë e bukura — 19 vjeçare.  
Dashuritë e dhëmsitura — 19 vjeçare.  
Dashuritë që vdesin  
ndër sulme si njerzit.

#### IV

1. Ditët rrokin netët, netët rrokin ditët.  
Sulm e kundrasulme partizanët hidhen,  
sulm e kundrasu'me nazistët vërviten.  
Nëpër brinja priten...

Nga era e gjakut  
tërbohet armiku,  
porsi dem i egër në një kasaphanë.

---

1) Ismet Çakërri, dëshmor i luftës Nac. Çlirimtare.

Çfarë? Popujt e vegjël?  
Popujt janë liri,  
janë stuhi lirie.  
dhe liritë kanë  
gjak - një oqean.

Mbyten armiqt tanë  
nëpër gjak lirie...

Netëve mbi ne — vetëm një grusht yje.

Korbë Drashovicë.  
Shamizeza lidhur, labja Drashovicë.

2. Njëzet ditë me radhë  
toka po lëngon; nën flagë të hekurit  
që shkriu në Rur.

20 ditë me radhë  
ëndërat e mia,  
nëpër pozicione nuk e mbyllën synë.

Dashurit' e mia  
fytyrë drobitur, e mjekër parruar,  
nëpër pozicione agimet i presin.

20 ditë me radhë...

Këtu te kjo grykë  
me vetë qikllopin,  
që hante liritë, gllabëronte kombet,  
ndeshet Shqipëria, ashtu, trup me trup.

# LIRIKA QYTETARE

---

## M B R È M È I K I S H A M I Q

Mbrëmë i kisha miq dhe me mua fjetën  
revolucionet e ardhshme, republikat e reja proletare;  
hidrocentralet ndërkombëtare dhe universitetet,  
udhëtimet e largëta, pafund ndërplanetare.

Mbrëmë i kisha miq dhe me mua fjetën  
yjet e panjohur, të paemërtat planete;  
dashuritë e reja - të rejat shqetësime,  
sulmet e këngëve të reja - të rejat mendime.

U mblodhëm të gjithë në këtë dhomë.

Duke pirë çaj u fjalosëm gjer vonë.

Dhe pastaj së bashku, ashtu siç qemë,  
në shtratin tim të vogël, pranë njeri-tjetrit,  
ramë të flemë.

## V A R G J E

Mbi maja të këmbëve  
nuk hyra në pallat të poetve  
dhe as që më shkoi në mendje  
duart t'i shtrinja mbi kurora dafinash mes gjetheve  
Shëmbëllej me një anije  
që ka për udhërrëfënjes yjet  
dhe yjet në dete të hapur i ndjek.  
I rash' pas yllit të lirisë së popujve,  
i rash' pas yllit të drejtësisë së popujve,  
dhe vahu më nxori këtu, në pallat të poetëve, në  
breg...

Sjell me vete erën e kripur të detit të Vlorës,  
vij me këmbë të plasura nëpër jalli;  
në ballë duken blanat që kamxhiku i kohës  
më rrahu mé furi.

Sjell kujtimin e Shyqyri Alimerkos,  
në dorë kam pushkën e Fejzo Gjmomemës  
dhe jam i çuditshëm: dua ato  
t'i fus në pallat të mermertë të poetve.

## KU NISI FËMINIA JONË...

Ku nisi fëminia jonë  
ju do të gjeni gjurmëzat e këmbëve  
nëpër guriçka të çara gjithmonë.

Ku nisi fëminia jonë  
ngrihet një pyll i dëndur bajonetash,  
Dhe njerëzit e huaj me helmëta,  
të egjër, nënë vetull na shikojnë.

Po nëpër bango shkruajnë gishtrinjt:  
«Të mirë u pafshim në Shqipërinë e lirë!»

Ku nisi fëminia jonë  
jeta nuk është gazetë e përditshme  
që e palos në xhep, kur shkon shëtitje.  
Jeta të fton në lodra të çuditshme:  
në male mund të rrish pa bukë dhjetë ditë  
dhe që ta shuash urinë, drejt nga gjitë,  
ashtu... si keci... mund t'i thithësh dhitë.

Ku nisi fëminia jonë  
këngët marshojnë para luftëtarve,  
si bubullima përpara tufaneve.

Ku nisi fëminia jonë,  
Atdheu ka një bukuri të dhimbshme:  
shokët..., dëshmorët..., bjenë radhë, radhë...

A kini parë ju shokë të vrarë?  
Shokët e fëminisë të vrarë i keni parë?  
Sa gjëra sot nuk mundem t'ju thom, —  
Kërkojini,  
ku nisi fëminia jonë.

## BREZAVE QË VINË

Un' jam këtu, mes ushtarëve të thjeshtë.  
Si drunjt e pyllit gjithë na mbulon  
ngjyra e gjelbër e kapotës së leshtë.  
E kush ushtarët në marshim dallon?  
Në krah' të gjithë hedhin një dyfek.  
Në brez shtrëngojnë vezmet me fyshekë,  
dhe kur marshojnë, në një hap marshojnë;  
dhe kur këndojnë, një këngë këndojnë.  
Me ju po flet sot një ushtar i thjeshtë:  
Kur rroka pushkën qesh dymbëdhjetë vjeç.  
Me këmbët zbathur, plasur vija-vija,  
i thjeshtë, i mitur, si vet Shqipërija,  
«Revolucioni» ishte fjalë e madhe,  
ahere dinja vetëm fjalën çetë  
edhe që çetat luftonin në male...  
Po shumë shpejt e pata kuptuar  
që çeta jon' në bark t'revolucionit  
lëvizte, si në pyll bish' e urtuar.

Revolucioni... si t'jua shpjegoj?  
N'revolucion gjithçka fytyrë ndrron.  
Në një varg kënge ti ndjen në çdo çast  
si frymë marrin jet' e vdekje bashkë.  
N'revolucion çdo zemër është' në flakë.  
Revolucioni nuk njihet kurrë mëshirë, —  
kush lyp mëshirë, bëhet qesharak!

Po unë edhe tani jam ushtar,  
se duhet që ta mbrojm' revolucionin.  
Revolucioni është' urdhër' i historisë,  
mbi supe tona gjith botën të ngremë  
e nëpër shekuj përpara të çajmë;  
revolucioni - janë ëndrat e njerzisë  
që n'mijra ngjyra e drita shkëlqejnë;  
n'revolucion të gjithë janë të çuditshëm:  
dhe më i vogli mendon për brezat,  
për njerzit që vijnë —  
revolucioni është' I Janari  
i botës son' të madhe që lind.

Prandaj qesh... u shikoj dhe qesh..  
Po vini ju të bukur, të gëzuar,  
si dielli pranveror në të aguar.  
Pa e dëgjoj tani dhe këngën tuaj!  
Pa e dëgjoj tani dhe hapin tuaj.  
Vini ashtu, siç u kam ëndëruar:  
të qeshur, të shëndoshë; gjithë dritë.  
Në zemrën tuaj të pastër e të dlirtë  
shkëlqeka drejtësia pa mbarim.  
Dhe bini ju shpesh herë në mendim  
për ditt' e mia e për fatin tim.  
E nëpër skena ngado po kërkoni  
sërish në botë ju të më krijoni.  
Vetëm nuk mundni, dot nuk e kuptoni  
se si mbi borë dhe kallkanet - hej  
gishtrinjt e ngrirë të këmbës hidhnja tej.

Të gjitha këto s'kanë rëndësi.  
Ju vetëm asnjëherë mos harroni:  
si një lisi të madh, revolucionit  
përmbi çdo degë i rrinin gemb e gjethe  
me pushkë në dorë, ushtarët e thjeshtë,  
njerëzit e thjeshtë...

BIBLIOTEKË E SHKËRTIMIT  
E JERIKOSTEP

~~82784~~  
11360

## L I R I S Ë

A të kujtohet ty  
si nëpër sulme, Liri, të kërkonim?  
Jo, s'të kërkonim! — Në ty të krijonim  
në çdo pikë gjaku e zemër njerzore,  
në djersë të ballit e duart puntore,  
në dhimbjet tona edhe në gëzimet,  
në këngët tona edhe në mejtimet...  
Se donim të takoheshim, Liri:  
në sytë e kaltër të vashave tona,  
në rrug' plot dritë dhe në bulevardë,  
ndër netët mesdhetare nëpër parqe,  
ndër vargje vjershash edhe nëpër shkronja, —  
se ne, Liri, me ty u dashuruam;  
për jetë u dashuruam.

## SI ERDHI TEK NE SHEKULLI XX

Shekulli XX-të

shkonte ngado mes dritash elektrike e gjëmime  
motorash  
me një libër dhe fletore të vogël shënimesh në xhep.  
Por tek ne autostrada të gjëra nuk kishte.

Dhe shekulli XX-të,  
që s'i njihte huqet e maleve tona, të kalonte këtej  
s'e kish lehtë.

Ahere «Çeta Plakë» vendosi e dërgoi korierin  
ta gjejë nëpër botë shekullin tonë dhe tek ne ta bjeri.  
U nis luftëtari partizan.

Nëpër shtigje të përgjakura të maleve tona e udhë-  
hoqi e mori...

Dhe ne për herë të parë shekullin e XX-të e pamë,  
kur sulmonte Drashovicës zorrëthatë e gjerdanin me  
morra,

K U B Ë S

*Në përvjetorin e revolucionit.*

Kubë! Kubë!

Shikoj këtë kupë  
të kaltër të qiellit shqiptar  
dhe dorën e ngrë: yjet i shtyj,  
të vinë, të mblidhen, të digjen  
dhe yjet e mia  
të gjithë mbi ty.  
Që mbi qiellin tënd  
të shkëlqejnë dhe yjet e qiellit tim, —  
me dorë po i shtyj.

## ERDHËN POETËT HAMENJ

Erdhën poetët hamenj.

Shqipëria e koha i kanë ngarkuar  
me kërcitjet e dhëmbëve të partizanve që s'flenë,  
nëpër netë thëllimesh, me pushkë në duar;  
(partizanët - statuja lirie në sfond të vjetve që  
shkuan.)

me dy ditë të kuqe në krahor  
të atdheut - 28 e 29 Nëndor;  
me trishtimet e vjeshtës, që na bëjnë kaq njerëzorë;  
me krisjet e shekujve, drejtësitë e revolucioneve;  
me shkrepëtimat... dritat.: me të gjitha zjarret  
e gjithë yjeve, që ndrijnë në botë të madhe;  
me gjithë fytyrat e dashurive njerëzore,  
dashurive të mençme, që kudo horizonteve  
edhe kur flenë,

prapë rrinë zgjuar.

Erdhën poetët hamenj. —

Shqipëria i ka ngarkuar.

## PSE ERDHA NË JETË...

Un' nuk erdha në jetë që të lus perënditë;  
që profetët e mykur mësonjës t'i kem;  
që duke biseduar të pyes: a u mërzite?.  
dhe i qetë në shtrate të lëçit pasdite,  
nëpër vargje budallë, poetët budallenj.  
Un' nuk erdha në jetë që të flé, kur s'më flihet:  
dhe mendja edhe zemra dhe shpirti të më flenë.  
Un' erdha që çdo cast i ngarkuar të jem  
me barrën e mendimit; un' erdha t'i blatoj  
këngë të gëzuara mejtimit të lirë,  
së vetë më e madhja bukuri në jetë  
është madhështia e mejtimit të lirë.  
Un' erdha të kuptoj  
që jeta është e bukur, e madhe sa shpesh herë;  
në madhësinë e saj gëzim e frikë ndjejmë.

8 V A R G J E

Mbi supe - një këmishë e hollë.  
Të pastra të jenë këpucët.  
Mendim i kthjelltë në kokë:  
Liri për gjith njerzit e bukë.  
Jeta është e thjeshtë.  
(Shkëlqimet s'vlejnë asgjë.)  
Dhe për ta kuptuar këtë  
mjafton vetëm njeri të jesh.

# PEJZAZH

---

## NË LLOGARA

Si kollona gjigande lëshohen gjer lartë  
trungjet e pishave qindravjeçare nëpër natë.  
Mbi kurorat e tyre ndër maja, si mbi kapitele,  
pështeten, tavane të botës së ëndrave, këta qieje.  
Sonte do flemë,  
nën këto kollona e kapitele,  
që mbajnë të mos bjenë,  
të mos rrokullisen mbi né këto ëndra e qieje.

## DITË VJESHTE

Qiejt e vjeshtës ranë  
ndër asfalte prej shiut të larë.  
Si një perëndi po eci  
mbi copra të bardha resh,  
mbi copra të kristalta të qiejve shqiptare.

## MBRËMJE

U ulën qiejt e Ballkanit  
me yje të mëdhenj —  
u pshtetën:  
ndër maja malesh mti këhtjella,  
përmbi kupola Bizantine,  
mbi shtylla minare-xhamish.  
Ndër muzgje qiejt e Ballkanit  
me yje të mëdhenj, u pshtetën  
mbi blloqe hiesh mesjetare. —  
që të dëgjojnë prej tokës sime  
pëshprima dashurish  
moderne.

# LIRIKA DASHURIE

---

## SI TË HARROVA TY...

T. G.

A i ke parë ti mbledhsit e ullijve?  
Duarbuavitur qëmtojnë ndër thëllime,  
nëpër baltë e shi, ullijtë që kanë rënë, —  
krrusur përmbi tokë mbledhsit e ullijve...  
Ashtu unë mblodha qetësira netësh;  
ditë të verdha vjeshte; një emër shqiptar:  
Margarita Tutulani, ndër gjëmime vjetësh  
një epitaf i dhëmshur: «Partizan pa emër»;  
në një gjurmë njeriu një kothere bukë,  
nën' të paska mbirë një mendim i bukur;  
ja dhe fjala paqë, si kordele e bardhë  
mbi flokë fëmijsht...

Ato duke mbledhur, si mbledhin ullijtë: —  
një kokërr këtu... një kokërr aty...  
Veten e harrova... të harrova ty.

## MË MORI MALLI...

Më mori malli për flokët e verdhë,  
që binin, mbulonin supet e bardhë e të rrumbullaktë,  
që binin mbulonin gjinjt e ngrohtë,  
thua sikur  
sekrete të shenjta do të më fshihnin,  
sekrete që shikimi im do t'i ç'shenjtëronte.  
Më mori malli për sytë e kaltër,  
dua të çlodhem në kaltërsinë e tyre....

## II

Vërtet, dikur qëndruam afër njëri - tjetrit  
më afër se unë me mendimet e mia tani.  
Vërtet kam përshkuar gishtrinjt  
nëpër flokët e verdhë  
dhe kam ndjerë  
nëpër mollza të gishtrinjtve fëshfërimat e flokëve  
të tu, —  
melodi të përzjera dashurish të turbullta  
dhe kam prekur me dorë shtatin tënd —  
qipariz i gjelbër pasionesh të bukura?

## DUKE TË PRITUR TY...

Duke të pritur ty, në kapotën e trishtimit i  
mbështjell,  
dëgjova të shkrepurit e yjeve që bridhnin,  
të shkrepurit e yjeve që rendnin nëpër qiell.  
Si ushtarët nëpër fushën e luftës kur sulmonin,  
përhapeshin yjet nëpër fushë qiellore.  
zinin vendet dhe ndrironin.  
Duke të pritur ty, në kapotën e trishtimit i mbësht-  
tjell,  
takat e tua s'i dëgjova,  
dëgjova të shkrepurit e yjeve nëpër qiell.

## KEMI SHUMË KALTËRSIRA...

Kemi shumë kaltësira qiellore  
që me duar dashurish  
duhet t'i afrojmë pranë vetes;  
kemi shumë mendime njerzore  
që bredhin nëpër turmën e përditshme  
dhe që duhet t'i mësojmë si nxënës;  
kemi shumë trishtime  
që duhet t'i shkullim prej zemrës.  
Dhe shumë fjalë që na mbetën për gjysëm  
e dot nuk i thamë  
kemi për t'i thënë njeri - tjetrit.

## EDHE SONTE...

Edhe sonte në kurrizin e rruzullit  
do të gjejmë një copë vend  
ku të ulet dashuria jonë.  
Edhe sonte, në çeturin e qiellit  
do të kërkojmë yllin,  
që i panevojshëm, mbi kokë na ndriçon.  
Dhe diçka të gezueshme,  
për t'i thënë njeri-tjetrit, do të gjejmë edhe  
sonte...

## TI DO VISH...

Ti do vish, e dashur, — si s'do vish?  
Kur e di se unë ty të pres  
duke ndjer' frymëmarrjen e vet mbrëmjes,  
duke ndjer' frymëmarrjen e vet pritjes,  
duke ndjer' frymëmarrjen e vetmisë.  
Ti do vish, e dashur, si s'do vish?  
Kur e di që unë po të mundnja,  
rreth vetvetes rruzullin do vërtitnja,  
si një portokall' në dorën time, —  
të rrjedhë koha shpejt  
e ti të vish...

N Ë V E T M I...

Vetmia thotë: pi! se dashuria  
dhe këtë kupë e mbushi për ty  
me trishtimin që ajo prapë s'erdhi,  
përzjer me mushtin e frikës meskine.  
Në këtë kupë dashuria derdhi  
hiet e kishës së vjetër bizantine,  
hiet e minaresë mesjetare, —  
Atyreve iu tremb...

E tek ty s'erdhi.

Dhe un' kthei kupën gjithë të përzjerë  
me aromat e flokut tënd të verdhë.

## MOS PRIT

Mos prit, nuk vi më në takim. —  
Më kotë mos më prit.  
Ndër kalimtarë me padurim  
shikimin mos vërvit.  
Ti vet ma preve: Lamtumirë!  
Eh, lamtumirë, pra.  
Mbi né-e kaltra hapësirë,  
nën' të-plot rrugë ka.

## A K U A R E L

Copra të kaltra qielli, copra të bardha resh.  
Në këtë sfond të gëzueshëm, ti u vendose tani,  
Kapa vizionin tënd... e qesh e s'kuptoj pse qesh:  
flokët pëshprima të verdha derdhin mantelit të zi  
që mbulon supet e dobta të **ktij takimi të varfër.**  
Ulet... e në sytë e tu veten sheh qielli i largët.  
Mes kornizash qerpikësh ti m'i prure kaq afër  
retë e bardha të qiellit, sfondet e tija të kaltër, —  
tërë dashurinë time mbyllur në këtë kuadër.

## N Ë P A R K

Në trup të natës hie nëpër hie  
duken e zduken forma dashurie,  
duken e zhduken siluheta té holla.  
Tungjatjetani! —

o dashuri të njoma.

Tungjatjetani! —

çaste pafajësie.

Dehur nga mushti pëshpërimeve tuaja —  
mes jush, — duken e zhduken vet si hie,  
si siluhetë e hollë dashurie.

## MILIONA DASHURI...

Miliona dashuri po nisen ndër takime.  
Të gjitha kanë qëndruar përpara pasqyrës.  
Shtrëngojnë me gishtrinjt e gjat' pincat e mprehta.  
E me durim qëmtojnë qerpikë dhe vetulla.  
E me kujdes i lyejnë buzët e fytyrën.

Miliona dashuri u nisën në takime.

Po ecin përmbi taka të holla e të shpejta.  
Dëgjoni trokëllimën e rrëmbyer të tyre?  
Nën trokëllimat-ritme të këmbëve të lehta,  
me një gëzim të kthjelltë, drejt dashurisë rend jeta;  
që kur s'qe aq e mençme, —  
sa kur shkoi në takime.

# I HODHA SYTË NGA LINDJA

## I

I hodha sytë nga lindja: ja, qielli i Bullgarisë!  
sa kujtime të mia nënë të po flenë.  
Dhe vetëm një rri zgjuar:

vitet që vinë e venë  
me dor' të fshehtë lëndojnë dhimbjen e dashurisë...

A je ajo që ishe? Ajo që që më parë?  
Në cep të buzës qeshjen, pas kaq vjetësh ndarë,  
s'ta lëndoi malli? Nën të zezën qepallë  
gëzimi fëminor çkujdesur po përgjon?  
A je kush që më parë?

Të kujtova ty dhe Bullgarinë kujtoj.  
Si mundem të ndaj ty nga Bullgarija?  
Bullgarija ja: një baluk breton  
mbi dy sy të kaltër, gazmor si fëmija.

## II

Bullgarija ja: një natë me yje  
nën degza të trishtme të shelgut shator.  
Tani ëndëro dhe kupto: ku je,  
me ty, edhe qiejt lartë ëndërojnë.

Një copë ré é bardhë në qiell kaltërosh.  
Rreth studentë e shokë lartë në Vitosh,  
Unë kokë-pështetur te gung e një pishe  
shikoj i habitur: ja, një studentesh'  
me sy kureshtar avitet e qesh...  
A s'është Bullgarija ajo që po qesh?

### III

Pa do thonë kritikët:

ku jan' Karaxhat dhe Haxhi Dimitrët,  
ku janë bullgarët e mëdhenj që vdiqën?  
Ç'është kjo: Bullgari!?!.. Ku është Botiovi,  
ku Kristo Smirnenski edhe Vapcarovi?

Nën perçen hajdute të zezë, të verdhë  
mos gjaku bullgar më bukur u derdh  
se nënë baluken ton' alla-lezherë?

Mos vallë ne studentët, që ckujdesur qeshim,  
për lirinë e shenjtë nuk ditëm të vdesim?

### IV

Dhe prap Bullgarija — një shikim çapkën  
tek pisha e gielbër në muzoun me hënë.  
Shiko: mbi Vitoshë qiejt tani ulen  
dhe mbi kryet tona po zmadhohen yjet...

Sidoqoftë, vargjet thuren keq a mirë,  
ti vetëm kupto si për Bullgarinë  
ëndëron nga larg një zemër e dliërë.

## V

Kujtoj Bullgarinë dhe të kujtoj ty.  
Po—më thua—ç'vlejnë kujtimet tani?  
Fytyra të zbeta të ditve që shkuan,  
pjellin e ushqejnë mendim të trishtuar.  
Gjithçka erdh e iku si ëndër e brishtë...  
O zot! Kur mendoj  
dridhem e tmerohem: koha po ma prish  
dhe vizionin e saj e po e mjergullon...

## VARGJE PËR HALIDËN

---

Nata me duar të lehta  
solli gjumin e ëmbël.  
Qerpikët mbylli e lodhur bota. Tani po flé.  
Heshtje mbi tokë edhe në qiell heshtje mbi në.

Huuu! Sa e madhe dhe e pafundme  
në këtë heshtje është gjithësia!

Ti pse u trëmbe, pse me nxitim  
kryet pështete në gjoksin tim,  
sytë i mbylle e porsi fëmijë,  
kur pranë ndjeve ngrohtësinë time, qeshe Halidë?

Oh! Sa e madhe dhe e pafundme  
n'heshtie të natës është gjithësia!  
Dhe më bashkon me botë të gëzueshme  
flokun yt që shpupuritët ndër duart e mia.

Flokun yt po shpupuritët ndër duart e mia  
e unë mendoj si iku ajo... rinia jonë.  
Erdhi dhe iku gjithë në një çast.  
Me gisht të bukur kupën qiellore  
na e tregoi, ku ré e bardhëz  
po fluturonte. Dhe në gjith gaz  
ngulëm shikimin ndër kaltërsira...

Po, përnjëherësh shkrepën stuhirat!  
Ahëre shpejtë,  
gjithçka që dukej aqë e shenjtë  
edhe e dhimsur—jeta tej hodhi...

Në çamë stuhitë porsi alqionet  
dhe s'patëm kohë as ta kuptonim,  
që porsi reja e bardh' guthmonë  
më tej largohesh e ikte ajo,  
rinia jonë...

Dielli lind e perëndon.  
Vjen pranvera e pastaj ikën.  
Dje që e gjelbër, po sot zverdhon  
gjethja e vogël. Tufanet frynë  
dhe e rrëmbyen në gji të vet.  
Do ikim shpejt...  
Dhe të trishtohesh s'paska kuptim,  
as kohë ka-bota po pret  
e dëgjon ajo:  
thuaj të gjitha ç'ke për të thënë  
shkurt edhe qart; mbi tokën-mëmë  
shkel i gëzuar dhe ashtu-shko!

Ndofta, s'po them asgjë të ré.  
Por kaq të vjetra janë madhështore.  
Ja, shekuj e shekuj fjete nën dhé  
kjo perëndeshë, kjo permendore,  
edhe u ngrit sot më e ré.  
Thuam-Halidë—  
valët e detit, erërat e qiellit  
erërat, që lart puthen, pushtohen  
dhe përmes puthjesh lindin stuhitë,

janë të vjetra apo të reja?  
Mijëra vjetë ndenji nën dhé  
kjo Afërditë, që sot me né  
heshtur flet me gjuhë kaq të ré.

Shkoj nëpër rrugë të porsa çelura  
dhe fishkëllej ndër buzë tani  
këngët e mia që askush nuk i njeh...  
Bota për mua gjithmon a s'qe  
hymn i triumfit të saj të ri?

Eci ndër rrugë të porsa çelura.

## II

Ngado të ecim  
prapë mbi ëndra do shkelim,  
përmbi mendime që kanë vdekur,  
a duhet të vdesin, - do shkelim,

Pra, mos u çudit, që këmba mbi dhé  
përçiku dhe shkundi urtësinë e vjetër.  
U zgjua ajo tani më e ré  
dhe më e bukur se kurdoherë tjetër.  
Dhe gëzohet urtësia e vjetër, kur sheh  
mendimin e ri që porsa lindi  
mbi ballin tonë e në buzë-këngën e ré.

Mos u çudit! Në rrugët e jetës,  
si mbi asfalt, pa u lodhur shtrojnë  
ëndrat, mendimet e tyre njerzit...  
Dhe né përmbi 'to - Halidë - tani shkojmë.

Ecim mbi ëndra që kanë vdekur,  
a duhet të vdesin... Atë qëndro!  
Në këtë çast e di ç'kanë shkelur  
këmbët e tua? A e di ti  
reliket e kujt tani po themon?  
Shoh nëpër shekuj si milionë  
njerëz të zbathur e pa këmishë,  
(një oqean i tërë njerëzor)  
një oqean gjaku derdhen  
për këtë ëndër... Ti shtyp tani  
atë që e quajtën dikur: Lumturi!

Të tjerë njerëz erdhën dhe pyetën:  
çfarë lumturie? Qe tërë jetën  
pika e lotit dhe bulz' e djersës  
nën mollz' të faqes të mblidhen bashkë  
dhe ne t'i fshijmë me dorë të trashë  
e të mos mundim dot në pëllëmbën  
tonë të dallojmë, djersa ku është  
edhe ku loti?

Lumturi tjetër  
botës i duhet! Dhe më e drejtë  
dhe më njerëzore... Kështu thanë  
edhe të parën ata e shtypën.  
Përmbi' të ti.  
me taka të holla qëndron tani.

Në rrugë të jetës  
si mbi asfalt, pa u lodhur, shtrojnë  
ëndrat, mendimet e tyre njerëz...  
Dhe në mbi 'to, Halidë, tani shkojmë.

### III

Tokën shqiptare  
 që po sodit, dikur, Qezari  
 e pati shkelur. Ndër këto brigje  
 ku ti qëndron  
 edhe shikon se si po digjen  
 thellë horizontet, qëndroi Qezari  
 edhe mendoi...

Heshtëte bota —  
 mendonte Qezari!

Po tani thuan, thuan, Halidë,  
 ushtar i madh a mendoi se një ditë  
 as harkëtarë, as ushtëtarë  
 s'do vigjëlojnë bregut të detit;  
 robët nën pranga s'do hiqen zvarë, —  
 po do të piqen nënë rreze dielli  
 njerëzit shtritur mbi rërën-ar?  
 Ditët që vinin me fytyrë të çuditshme  
 s'mundi t'i shohë dot as Qezari?  
 Në gji të kohës është i vogël  
 dhe ai i madhi?

Dhe asnjë kohë nuk është e frikshme.  
 Çdo kohë e urtë është dhe e madhe.  
 Heronjtë e vet rritë çdo kohë  
 dhe xhuxhmaxhuxhët, sahanlëpirsit e saj, ka ajo.  
 Por unë e dua kohën time  
 se si vigane ajo u ngrit  
 mes e përmes historisë...  
 Tani marshon...  
 Dhe nënë këmbën e saj gjigande  
 shtypen, kërcasin kock' e kokalla

të botës vjetër që po jep shpirt.  
Shekujve, brezave që radhë vinë  
koha ime u del përpara, —  
qesh kur i sheh...  
Dhe mban në duart e saj agimin  
e botës së ré.

Un' e dua kohën time,  
se ti, Halidë, në 'të jeton.  
Ti... që tani me gjithësinë  
po më bashkon...

# NE I THYEM QIEJT E TURBULLT TE SHQIPËRISË

---

Jam i ngarkuar me dashurinë  
e vendit tim dhe në çdo zemër  
të botës puntore, si ndër limane  
një anij' e madhe,  
tani shkarkoj shpres' e gëzim  
nga Shqipëria.  
Unë jam poet i vendit tim.  
Si ré të ngarkuara  
përpiqen mendimet që vetëtijnë  
e shkrepëtijnë.  
Janë mendimet e Shqipërisë që po ju sjell.

## II

Shqipëria... në çdo dhjetë hapa,  
mbi maja malesh — një kështjellë.  
Në breg të detit ullinjt shatorë  
ty të mbulojnë. Mënjano degzat ashtu me dore  
dhe shih përpjetë qiejt e kaltra.  
Ngjyrëzat blu  
vallzojnë mbi ty plot shkëlqim.  
Dhe, nënë 'to  
Shqipëria analfabete, thellë në mendim,  
rreh të shkoqisë  
librin e turbullt, të ngatërruar të historisë,

### III

Popujt mundet të zgjohen dhe mund të flenë;  
shpresa dhe ëndra mund të ushqejnë;  
popujt Atlase mundet të jenë,  
mund të krijojnë vetë Promethenë.

Popujt

janë të thjeshtë dhe të mëdhenj.

Se madhështia e vërtetë  
përherë që dhe është e thjeshtë.

Shqipëria

me gishtrinjt e saj të trashë,  
të plasaritur, me mëllere ugari,  
përmbi ballin e historisë tani troket.

### IV

Asaj nate të zezë, pisë,  
që i thërrasin: «Lufta e Dytë»,  
tiranisë e robërisë  
i vumë zjarr... që të kish dritë,  
që të shikonte më mirë Shqipëria  
edhe të dinte se ku do shkelte  
me këmbë të zbathura... Se Shqipëria  
sa mori urdhrin  
e historisë e nisi udhën.

### V

Tani marshon në radhë të para,  
si një ushtar krah shokve të vetë.  
Shkon Shqipëria ashtu si është;  
shihni ndër rrugët që ka Tirana,

nënë mimozat, ndër bulevarde,  
përmbi pavazhe,  
shkelin njëherësh,  
oping' e llastiktë dhe këpuca shik;  
era e pranverës  
puth dekolletet me atë vrap që prek dimitë...  
Ndofta, një çast shumë ekzotik  
i historisë është tani vetë Shqipëria.  
Por ajo ecën e shkon përpara.

## VI

Ecën... e mban e sjell ndër duar  
shpatë të mbprehtë, trimërinë e saj,  
Mund ta marrin cilët të duan.  
Në dorë të patrembur mund ta mbaj  
çdo luftëtar që kërkon lirinë.  
Shqipëria sjell dashurinë  
e pafundme për njerëzinë  
edhe për jetën.  
Mblidhen në zemrën e Shqipërisë  
gjithë gëzimet edhe gjithë dhimbjet  
e vegjëlisë sonë proletare.  
Dhe ajo vetë rreh si një zemër  
në kraharorin e botës së madhe.

## VII

Ç'thotë kritiku? Vargu im pak melodik  
mbështjell mendimin kryeneç e të egër?  
Dëgjo kritik!:  
nuk të drejtohem  
që të vërtetoj se është e përjetshme  
luft' e «kritikëve» dhe e poetëve...

S'erdha në jetë  
që emëri im stoli të jetë  
në buzët e tua kur mban fjalim.  
S'erdha në jetë  
që si barbarët që mbajnë nën hundë  
copëra hekuri,  
unë të mbaj nën hundë e të tundë.  
stoli të rëndë, emrin poet.

## VIII

Pashë si ecin njerzit mbi tokë:  
dikush me buzët e tij të shpejta,  
hukit dhe u fryn gishtrijve të ngrohtë  
dhe pëshpërit lavditë litani.  
Ai e di: mund të falë jeta  
kërbaçin e bukën të dyja njësoj —  
dhe i pranon të dyja njësoj.  
Tjetri, ashtu si kurva e keqe,  
kërkon tani që nga buzët e jetës  
të vjedhë, për shekuj, lavdinë e vetvetes.

Unë eca me popullin tim.  
Kurrë s'qesh vetëm. Në udhëtim,  
a ndër ugare, kur ngisnim qetë,  
mbuluar në djersë, u ulëm për drekë,  
mbi plisa të thatë pecetën shtruam  
dhe hëngrëm misërnike me qepë.  
Kur pashë varfërinë e popullit tim  
zemra më theri e sytë m'u verbuan.  
Vargu qënka pak melodik?  
He, pra! Tani afërsisht një rimë:

mes zjarrit dhe hekurit Shqipëria u turr,  
me zjarr edhe hekur armiqtë i zhdukëm,  
që më para bukës të mos dridhemi kurrë,  
që më të mos kemi frikë dhe për bukën.

## IX

Shpesh herë rri edhe mendoj  
mbi vargjet e mia...  
Por po të flisnja më me pakë guxim  
s'do të ma falte kurrë Shqipëria,  
s'do të ma falte populli im.  
Prandaj tani në çdo zemër të njerëzisë,  
vij e shkarkoj shpresë e gëzim,  
duke kënduar: ne i thyem qiejt e turbullt  
të Shqipërisë.

## U DOLA PËRPARA AGIMEVE....

---

U dola përpara agimeve të mëdhaja,  
kur bota përtypte  
hekur... hekur... hekur...

Në kurrizin e globit  
marshonin ushtri të çuditshme:  
ushtri njerzish, gavetash,  
ligjesh, galetash,  
ushtri batanijesh  
e flamujsh.

Dhe  
inkuizitorët modern të lirive të reja  
marshonin — ordi, nën helmëta.

Nën helmëta — qelbje mejtimesh.  
Nën helmëta — qelbje prej krimesh.

U dola përpara agimeve të mëdhaja,  
kur bota me nofulla të veta,  
përtypte tragjedinë e saja.

Dhe bënte ftohtë. Ftohtë. Ftohtë.  
Unë ecnja me këmbë të z bathura,  
mbi mendime të ngrira prej frikës.  
Putrat më çaheshin, nëpër ngrica ndjenjash;  
të thyera si copra qelqesh.

Dhe bënte ftohtë. Ftohtë. Ftohtë.  
Dhe vetëm marrëzia e botës digjesh.  
Njerëzit në marrëzinë e tyre ngrohni duart.  
Rruzulli shëmbëllente në një buall,  
me lekurë të përzhëritur,  
që përtypte vetëm hekur... hekur... hekur....

Isha kaq i vogël —  
para çmendurisë së madhe të kohës;  
isha kaq i paditur, —  
para tradhëtisë së mençme të botës.

Unë isha i vogël, kërthi —  
para krimeve të thinjura.

Dhe me sy të pafajshëm fëmënor  
shikonja në ato ditë luftrash i tmeruar,  
si në retinën e syve të shqyer  
të shekujve.

Dhe me turmat, që vërshonin si lumi,  
rreth prushit të marrëzisë njerëzore,  
vajta dhe unë të ngrohja duart.

Dhe më mori gjumi...  
Dhe më zuri gjumi...

## II

Dikush, me dorën e tij të ashpër,  
më shpupuriti flokët  
e më ngriti peshë në ajër.  
U zgjova me llahtar,  
kur ai më tha: mos u frikso... mos u trishto...  
S'ke ardhur në jetë  
as vonë e as tepër shpejtë —

ke ardhur në kohë.  
Dhe me gishtin e tij të madh  
më shtypi majën e hundës përpjetë  
e qeshi.

Nga e qeshura e tij horizontet gjëmonin —  
ishte revolucioni..

Më shkoi dorën e ashpër  
nëpër flokët e shpupuritur  
dhe përnjëherësh nën kafkë  
u përflakën mendime të ndritur.

Dhe pashë:  
nëpër gërmadha, mes atij të ftohti;  
shpërthenin prapë mendime të bukura.  
Me kapotat e leshta mbështilleshin liritë.  
Nga rrudhat e ballit të botës,  
rinia e jetës lindte  
si nga valët e detit një Afërditë.

Unë ecnja zbathur mes atij të ftohti  
dhe ndjenja: kurrizin e globit  
e përshkonin,  
si mornica gëzimi,  
uturimat e revolucionit.

Nga e qeshura e tij, si e qeshura e një demoni, ==  
kohrat gjëmonin...

Rruzulli përtypte hekur... hekur... hekur...  
Nën çizmet me gozhda të SS-it  
ëndrat e njerëzve  
si copra kallkani thyheshin.

Po njerëzit filluan të pyesin:  
pse kështu?  
Njerëzit thoshnin: mjaft më kështu!

Dhe bisedonin  
me revolucionin.

Dhe unë me lehtësinë  
që zgjidh një gllomçe të shamisë,  
zgjidha ashtu  
kuptimin e madh të historisë.  
Unë e kuptova: njerëzit bëjnë historinë,  
kur pyesin: pse kështu?  
kur thonë: mjaft më kështu!

### III

Unë i përkas revolucionit,  
Asnjë medalion,  
asnjë, distingtiv nuk mbaj në krahor,  
veç si medalje të thjeshtë kujtimi  
plagën e shokve të rënë.

Rreth qafës  
nuk vara kurrë,  
as Jesu Krisht e as Gjysëmhenë.  
Mbaj hajmali, një copë të flakës,  
së revolucionit.

Unë jam i turbullt, si dallgët  
e turbullta të revolucionit.

Që kur e kuptova se gjithë bajonetat,  
gjithë piramidat,  
gjithë ligjet gjakatare,  
s'vejnë as sa karficat, me të cilat kopsitim  
flokët e vajzave — i përkas komunizmit.

Eci nëpër botë e shtrydh e rrufis,  
si limon të verdhë: dashuritë,  
mendimet, dëshirat. I shtrydh, i rrufis.  
Dhe pastaj,  
si limonin e verdhë — i hedh tej.  
Vetëm njerit i qëndroj besnik  
përgjithnjë e gjer në vdekje — komunizmit!

Unë jam i turbullt.  
Dhe botën mund ta hosh të kthjelltë  
vetëm mes dallgëve të turbullta të revolucioneve;

Eci në jetë,  
jo si provincial i gjerë, që sytë i shqyen  
nga dritat e reklameve të neoneve.

Të gjitha dritat e horizonteve,  
të gjitha dritat e mendimeve të revolucioneve,  
i futa  
dhe ndjej vibracionet e gëzuara të tyre  
nën këtë këmishë të pastër me lulka.

Dhe nuk i lyp kurkujt as urrejtjen e as  
dashurinë;

as mbrojtje e as ndihmë.  
Më mjafton që me dorën e tij të ashpër,  
flokët m'i shpupuriti revolucioni im.

Unë  
U dola përpara agimeve të mëdhaja.  
Nëpër muzgjet e tyre eci  
mbi eshtra e skelete shekujsh.  
Dhe kur lodhem — për t'u çlodhur —  
më dëgjoni?,  
për t'u çlodhur kryet e turbullt pështes  
mbi supe të revolucionit.

# REPUBLIKËS

---

Qielli me ré,  
Retë —  
vello e zbetë  
në fytyr' të hënës.  
Nën qiell me hënë tani ëndëroj.  
Nën qiell me hënë tani po kujtoj.

Kujtoj Teli Ndinin.  
Ishte dhe s'është më.  
Një jetë njeriu në një varg pushon,  
në një varg pushon femënia jonë.  
Ishte dhe s'është më.

Nga toka po marr një grushtë me dhé.  
Qëndrojnë këtu ëndrat e Tel Ndinit.  
Ëndrat që ushqyem për tër' njerëzimin.  
Nga ky grusht me dhé  
Teli po na sheh...

S'e zgjova kujtimin  
me shkëlqim të tij të ndritë vargu im, —  
desha për Tel Ndinin  
të gjithë të dinë.

Edhe ai ishte,  
por tani s'është' më...

Kjo: «nuk është më» — a s'është' e çuditshme?  
Po s'është' e çuditshme  
që ka patur ditë,  
Republika ime, kur dhe ti nuk ishe?

Unë tani kam frikë  
edhe ta mendoj  
se ka patur ditë, kur pa ty jetonja.

Qielli me ré.  
Retë  
vello e zbetë  
në fytyr' të hënës, që bën dashuri  
me diej e yj.  
Ne humbëm Tel Ndinin  
dhe të fituam ty.

## II

Buka është' e shtrenjtë.  
Nuk do ishte keq  
këpuca të shitesh edhe më e lirë.  
Po kush tha atje:  
«Kështu qem dhe dje».

Shqipëria kishte një ka të dregosur.  
Ndër qytete shkelte me oping' me gjalmë.  
Shqipërin' e mundte një konup i vogël.  
Në hakmarrje vriste vetveten e saj.

Shqipëria s'mbillte lule nëpër udhë.  
Në qerren e vogël dremiste mbi llucë.  
Shkronjat e mërzitshme s'kuptoheshin shumë.  
Nën shkres' të fajdesë, gishtin vinte vulë.

Shqipëria kishte sy shumë të përdhimshëm,  
ku vdisnin sa lindnin ëndrat grumbull-grumbull;  
Shqipëria thurte legjendë për misër,  
kur vetë ajo ishte legjendë e turbull.

Shiko Shqipërinë: edhe këmbëzbathur  
prapë shkon në shkollë:

Gëzimit të saj dot nuk i beson  
fabrikat kur ngrë; ajo bëlbëzon  
kur ndër dhëmbë thotë fjalën: «tornitor»;  
Shiko Shqipërinë: me durim dëgjon  
pa çka që Bet'hovenin dot nuk e kupton.

Buka është e shtrenjtë.  
Nuk do ishte keq  
këpuca të shitesh edhe më e lirë:  
Merr' këtë gotë birra.  
Bromp! Ngrije ta pimë.  
Sot jemi më mirë.

### III

Ty të dashurova për ëndrat e tua.  
Për mendimin tënd të kthjelltë, të urtë.  
Republika ime! Ne çfarë kërkuam  
veç paqë e bukë?

Ne mbjellim ullij  
Me ullinjt ngrejme parqe.  
Duam çdo njeriu në botë t'i dhurojmë  
një degëz ulliri nga vendi i ynë  
që të dashurojë  
ullijtë e paqën.

Dhe paskemi faj ne,  
në qoftë se ëndrat tona njerëzore  
i tmerojnë tani armiqtë mbi dhé?

Ty të dashurova sepse je e pastër.  
Se s'më urdhërove që të lidh në trarë  
dhe të pushkatoj ëndëra të lira;  
nuk më urdhërove ndonjë popull tjetër  
të shkel e të shtyp.  
Unë ushtar-halldup?  
Dridhem e tmerohem tani kur mendoj:  
po të kishin dhënë një urdhër të tillë,  
çdo të kishte ndodhur ahëre atdhe?

Dhe faj kemi ne,  
në qoftë se bota jonë kaq e dliër  
i tmeron tani armiqtë mbi dhé?

#### IV

Sa gjëra s'i dinim!  
Edhe ku t'i dinim?  
Ku ta dinim vallë  
se do vinte dita,  
kur do të mendonim mbi fytyrën tënde  
kështu Republikë.

Ishte ditë Shendreu kur shkova në fshatë,  
Në katund gratë  
me burrat përleshën:  
kryesia bleu dysheqe me lesh,  
po ku tunden burrat?!  
— Lekët për ditë pune!

Mbi tokë kemi fjetur, mbi tokë do flemë dhe mbi  
tokë do vdesim-  
Ç'na duhen krevatet me dysheqe lesi?

Aher' kryetari  
koburen e nxori edhe urdhëroi:  
— Met Guri i pari,  
marsh! shtretët t'i marri  
me grua të shkojë  
dhe t'i shtrojë fëmitë.

Shikova koburen  
dhe... të shkela synë  
ty, o Republikë.

Ku ta dija unë,  
se do vinte një ditë  
të ta shkelnja synë  
ashtu, Republikë?

## V

Do të vinë pas nesh njerëzit me radhë.  
Me këmishë të kuqe, me këmishë të bardhë;  
pantallon të gjerë, të ngushtë, të hollë  
dhe mbi tavolina e nër parqe vonë  
për shumë e shumë gjëra do të na gjykojnë. —  
Oh! Si do gjykojnë.

Por kryet do ulin para luftës sonë.

## VI

Ti që më dëgjon  
me cigar në buzë;  
që ke veshur sot pantallon të hollë  
e të bardhë bluzë. —  
Ti je kaq i ri...

Të shikoj tani  
dhe ma turbullon zemrën një gëzim.  
Ti ndofta s'e di  
sa të dua ty, sa dua rininë.

Shikoj qiellin lart.  
Yjet që digjen edhe xixëllinjë  
si ëndra rinie.

Ai qiell i kaltër  
më kujtoi rininë...

Të dua ashtu, kur shkon i shkujdesur  
duke kënduar këngë ndër buzët e holla  
e me sy të qeshur;  
të dua ashtu kaq të padurueshëm  
se po kalon koha,  
se ora kalon  
dhe të pret tani shoqeza e ngrohtë  
nën shelg që vajton.

Dhe un' jam i ri,  
e me ty do vi  
sonte nën shegulkë.  
Vashën bashkë me ty dua që ta puth  
në cepin e buzës.

Dhe un' jam i ri  
edhe ta dish ti:  
si fëmi trishtohem kur në botën tonë  
ka qoftë dhe një vajzë që s'më dashuron.

Por një çast më prit.  
Pritmë t'i këndoj vargjet Republikës.  
Se ja Republika e vogël, e pakë,  
veshur me shajakë,  
mbi supet e njomë  
po i mban gjithë ëndrat e shekullit tonë.

---

**PASQYRA E LËNDËS**  
**NETË NËN ARMIKUN**

|                  | Faqe |
|------------------|------|
| Coprifuoco ..... | 4    |
| Robërit .....    | 5    |
| Drashovica ..... | 6    |

**LIRIKA QYTETARE**

|                                   |    |
|-----------------------------------|----|
| Mbrëmë i kisha miq .....          | 12 |
| Vargje .....                      | 13 |
| Ku nisi fëminia jonë .....        | 14 |
| Brezave që vinë .....             | 16 |
| Lirisë .....                      | 18 |
| Si erdhi tek ne shekulli XX ..... | 19 |
| Kubës .....                       | 20 |
| Erdhën poetët hamenj .....        | 21 |
| Pse erdha në jetë .....           | 22 |
| 8 vargje .....                    | 23 |

**PESSAZH**

|                    |    |
|--------------------|----|
| Në llogore .....   | 24 |
| Ditë vjeshte ..... | 25 |
| Mbrëmje .....      | 26 |

**LIRIKA DASHURISË**

|                             |    |
|-----------------------------|----|
| Si të harrova ty .....      | 27 |
| Më mori malli .....         | 28 |
| Duke të pritur ty .....     | 29 |
| Kemi shumë kaltërsira ..... | 30 |

|   | Faqe |
|---|------|
| Edhe sonte .....                                | 31   |
| Ti do vish .....                                | 32   |
| Në vetmi .....                                  | 33   |
| Mos prit .....                                  | 34   |
| Akuarel .....                                   | 35   |
| Në park .....                                   | 36   |
| Miliona dashuri .....                           | 37   |
| Dy sy nën ombrellë .....                        | 38   |
| I hodha sytë nga lindja .....                   | 40   |
| Vargje për Halidën .....                        | 43   |
| Ne i thyem qiejt e turbullt të Shqipërisë ..... | 49   |
| U dola përpara agimeve .....                    | 54   |
| Republikës .....                                | 59   |